**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË / OSNOVNI SUD MITROVICA**

**GJA.nr. 11/2024**

**Datë: 08.04.2024**

**Nga: Bekim Veliqi – U.D. Kryetar i Gjykatës Themelore Mitrovicë**

**Për: Këshillin Gjyqësor të Kosovës**

**Lënda: Raporti i punës së Gjykatës Themelore Mitrovicë për tremujorin e parë të vitit 2024**

Në bazë të nenit 14 par.2 nën par.2.4 dhe 2.5 të Ligjit Nr.06/L-054 për Gjykatat dhe nenit 11 par.5 të Rregullore Nr.02/2020 për organizimin dhe veprimtarinë e brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, në cilësinë e U.D Kryetarit të Gjykatës Themelore Mitrovicë paraqes Raportin Vjetor të punës së Gjykatës Themelore Mitrovicë.

Gjykata Themelore Mitrovicë ashtu si gjatë vitit 2023, edhe në fillim të vitit 2024, në tremujorin e parë të tij ka vepruar në përputhje me Planin Vjetor të Punës së Gjykatës në lidhje me organizimin e punës së Gjykatës, e poashtu edhe në pajtim me Planin Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022 – 2025.

Gjykata ka arritur që kënaqshëm të menaxhojë punën dhe veprimtarinë e saj, përkundër rrethanave të krijuara tash e gati dy vite, ashtuqë përkundër vështirësive që ka hasur kjo gjykatë nuk kanë munguar rezultatet e punës si për vitin paraprak ashtu edhe për tremujorin e parë të vitit 2024.

Gjykata rëndësi të veçantë i ka kushtuar zbatimit të planeve strategjike të miratuara nga ana e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës, rregulloreve të punës dhe udhëzimeve administrative, ku edhe gjatë këtij viti në periudhat kohore tremujore do të bëhet edhe raportimi i punës së Gjykatës pranë Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës.

Sa i përket organizmit të punës së gjyqtarëve pranë Gjykatës Themelore Mitrovicë është zbatuar Plani i Punës për vitin 2024 ku janë përcaktuar të gjithë gjyqtarët të cilët kanë vepruar pranë departamenteve dhe divizioneve përkatëse, për gjyqtarët janë siguruar kushtet e punës, të njëjtit janë sistemuar në zyre dhe zyret kanë qenë me të gjitha pajisjet e nevojshme për punë, me sfida në Departamentin Civil të kësaj gjykate për shkak të renovimit të objektit në Mitrovicën Jugore.

Gjykata edhe në fillim të këtij viti i ka kushtuar rëndësi përfundimit të lëndëve të natyrës së korrupsionit në lëminë penale sipas Planit Strategjik por jo vetëm keto. Përkundër organizmit të Gjykatës, probleme të konsiderueshme kemi pasur me Departamentin e Përgjithshëm – Divizionin Penal për shkak të numrit të kufizuar të prokurorëve dhe mungesave të tyre në seanca gjyqësore, probleme këto që janë adresuar edhe pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, gjë që ka rezultuar me dështimin e një numri të madh të seancave gjyqësore, mirëpo kjo nuk e zbeh aspak angazhimin dhe përformancën e mire të gjyqtarëve, të cilët kanë vepruar në

përpikmëri me Planin strategjik dhe Regulloret në fuqi, duke u zotuar për realizimin e planit dhe rritjen e përformancës në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.

Aktualisht, Gjykata Themelore në Mitrovicë ka filluar me caktimin e e kolegjeve e trupeve gjykuese në mënyrë automatike përmes sistemit elektronik SMIL, duke ndërprerë praktikën e deritanishme të caktimit të trupeve gjykuese përmes vendimeve të Kryetarit të Gjykatës.

Një angazhim serioz kemi pasur edhe në Divizionin Civil, ku performanca dhe angazhimi i gjyqtarëve dhe stafit të gjykatës ka qenë maksimal, përkundër situatës që janë përballur kohet e fundit gjë që ka rezultuar që ky divizion të hasur në më tepër vështirësi në realizimin e objektivave të planit strategjik, e megjithatë rezutatet e arritura në këtë divizion janë të mira për këtë tremujor, gjë që lë të kuptojmë se përkundër vështirësive.

Bashkëpunëtorët Profesional edhe në këtë fillim vit kanë ofruar mbështetje profesionale, jo vetëm për gjyqtarët, por edhe për gjithë Gjykatën në përgjithësi, duke ofruar kontributin e tyre me të gjitha kapacitetet profesionale, e kjo pasqyrohet mjaftë mirë edhe nga raportet mujore të punës që të njëjtit i kanë dorëzuar për raportim U.D Kryetarit të Gjykatës, po ashtu edhe nga vlerësimet që janë bërë nga ana e gjyqtarëve për bashkëpunëtorët profesional vërehet se të njëjtit janë të kënaqur me angazhimin që e kanë pasur dhe ndihmën profesionale të cilën kanë ofruar.

Ndarja e lëndëve në punë tek secili gjyqtar siç është përmendur edhe në raportet paraprake është bërë në mënyrë proporcionale përmes programit SMIL e sipas nevojës edhe sipas vendimit të Kryetarit të Gjykatës, siç është përcaktuar me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm të Gjykatave dhe Rregulloren e përdorimit të programit SMIL. Në procedurën paraprake pranë Departamentit të Përgjithshëm, Departamentit për Krime të Rënda dhe Departamentin për të Mitur, ndarja e lëndëve është caktuar sipas kujdestarisë tek secili gjyqtar në periudha të caktuara kohore sipas marrëveshjeve të gjyqtarëve, po ashtu edhe në Divizionin Kundërvajtës lëndët janë pranuar sipas kujdestarisë tek secili gjyqtar.

Duhet të theksohet fakti se lëndët janë trajtuar sipas ardhjes së tyre në Gjykatë, me përjashtim të rasteve të cilat kanë prioritet ligjor, siç janë rastet me paraburgim, rastet e dhunës në familje, rastet korrupsionit dhe krimit të organizuar apo rastet e marrëdhënieve familjare nga fusha civile, po ashtu edhe ato raste që janë paraparë edhe me planet strategjike të miratuara nga ana e KGJK-së.

Në periudhën e I-rë të vitit 2024 janë mbajtur takimet e rregullta të punës gjyqtarëve të Departamentit të Përgjithshëm dhe atij për Krime të Rënda, te Divizoni Civil. të cilët kanë paraqitur të arriturat e secilit departament, sfidat dhe objektivat të cilat synohen të arrihen brenda vitit 2024 dhe të njëjtat ia kanë adresuar Kryetarit të Gjykatës, i cili ka thirrur dhe mbajtur edhe takimin e rregullt – kolegjiumi tremujor, në të cilin janë diskutuar të arriturat, sfidat dhe synimet për këtë vit.

Sa i përket efikasitetit të përfundimit të lëndëve, rezultatin në lidhje me këtë çështje do ta elaborojmë si më poshtë, duke pasqyruar edhe statistikat në formë tabelare të nxjerra nga sistemi elektronik për menaxhimin e lëndëve SMIL:

**Në Departamentin për Krime të Rënda** sa i përket lëndëve në procedurë paraprake, të njëjtat lende janë caktuar tek gjyqtarët sipas kujdestarisë. Në periudhën raportuese në punë ky Departament ka pasur rreth 177 lëndë, per periudhën tre mujore te pranuara kane qene 54, ndërsa të zgjidhura 45, por zgjidhja e lendeve ne procedurën paraprake m`varete nga veprimet

e Prokurorisë, por ne DKR, lëndët jane me serioze dhe kërkojnë hetime me te gjata ne vërtetim me objektiv te çështjeve te ngritura.

**Në Departamentin për Krime të Rënda** norma e zgjidhjes në raport me lëndët e pranuara për këtë periudhë tremujore është 274%, janë te pranura 31 lende te reja ne kete tre mujor, ndërsa janë përfunduara 85 lende dhe numri i lëndëve në punë ka qene 737 lëndë. Përveç se jemi njeri nga Departamenteti me numrin më të madh të lëndëve dhe ngarkesën më të madhe me lëndë ne nvile te gjykatave, jemi po ashtu Departamenti qe per kete periudhe raportuese ka kryer numrin më të madh të lëndëve në nivel vendi.

Gjatë kësaj periudhe për të cilën është hartuar ky raport janë përfunduar 85 lëndë dhe numri i lëndëve në pritje është 652 lëndë. Ecuria e zvogëlimit të lëndëve në këtë departament, me ato të pranuara është me rrjedhë pozitive të vazhdueshme së paku në këto dy vitet e fundit, dhe trendi është premtues për një zvogëlim të mëtejmë të lëndëve në këtë departament, që shifra deri në përfundim të vitit, përkundër ngarkesës të jetë ende më e vogël, që në nivel të vendit jemi Departamtenti me më së shumti lëndë të perfunduara edhe pse me numër më të vogël me gjyqtarë, rezultati i kryerjes së lëndëve ka ndikuar edhe në ngritje të performancës së Departamentit për Krime të Rënda në nivel të vendit. Gjyqtarët në këtë departament kanë pranuar lëndë që janë trashëguar me vite të tëra për shkak të rrethanave të njohura.

**Në Departamentin për të Mitur** për këtë tremujor kemi pasur një trend pozitiv në raport me lëndët e pranuara dhe ato të kryera dhe gjyqtarja pranë këtij departamenti ka angazhim serioz dhe profesional dhe mbështetje ka edhe nga bashkëpunëtori profesional dhe zyrtarja ligjore, që ka rezultuar me të dhëna statistikore që për këtë periudhë kohore kap një përqindje të lartë, por evidente në Departamentin për të Mitur pranë Prokurorisë Themelore në Mitrovicë ka qenë edhe mungesa e Prokurorëve për një periudhë kohore e që sipas njoftimeve tani kjo Prokurori ka angazhuar dy prokuror dhe përpilimi i akteve do të jetë i një niveli tjetër.

**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal** tani është funksional me pese (5) gjyqtarë, tre(3) nga këta janë ende ne fazën praktike te trajnimit qe përfundon ne fund te këtij muaji, gjate kësaj kohe te gjithë kanë treguar angazhim maksimal në zgjidhjen e rasteve në kohë të arsyeshme. Ky departament ka pasur lëndë të bartura, e edhe gjatë kësaj periudhe që po raportojmë ka pasur problem me mungesa të shumta të prokurorëve në seanca gjyqësore që kanë rezultuar me shtyerje të shumta të seancave gjyqësore, përfshirë edhe ato që kanë qenë në rrezik të parashkrimit.

Ky Departament ka pasur në punë gjatë këtij viti gjithsej 1331 lëndë, dhe gjatë periudhës së parë raportuese ka përfunduar 103 lëndë, ndërsa lëndë në pritje kanë mbetur 1228 lëndë, me normë të zgjidhjes prej 73%, kjo përqindje jo e mire mund te jete faktor i shume rrethanave duke filluar mungesa e prokuroreve ne disa seanca, pastaj mungesa e dërgimit te ftesave ne adresën te palëve sidomos ne pjesën veriore, pastaj ne raste te caktuara palët jashtë vendit, te gjitha këto kane efektin vet ne te dhëna statistikore qe e ballin ketë Departament.,

Vlen të ritheksohet se ky divizion e mbulon edhe Degën e Zubin Potokut dhe Leposaviqit, dhe gjatë kësaj periudhe raportuese gjyqtarët në këtë divizion janë ngarkuar me lëndë nga këto dy degë dhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2024 ky divizion sa i përket lëndëve nga Dega në Zubin Potok ka pasur këtë gjendje: Numri i lëndë në punë në këtë periudhë raportuese kanë qenë gjithsej 81 lëndë, ndërsa janë zgjidhur 7 lëndë, ndërsa në pritje kemi 74 lëndë, me një normë të zgjidhjes prej 78 %. Gjatë kësaj periudhe në këtë Degë janë pranuar 9 lëndë, ndërsa sa i përket degës në Leposaviq, për periudhën e parë raportuese kemi pasur këtë gjendje: Numri i lëndëve te pranuara për ketë tre mujor ka qene 53 lende, te kryera 97 lende, ne pune kane qene

gjithsej 394, në pritje tani kemi 297 lëndë, me një normë të zgjidhjes prej 183% qe është nga ato te pranuara me ato te kryera.

Për periudhën e parë raportuese për vitin 2024 Gjykata sipas statistikave ne lemin penale ka pasur angazhim, përqindja e përgjithshme ka qene 100%, por kjo nuk mjafton presim angazhim me te larte te trajtimit ne DP.

Sipas rezultateve të theksuara për këtë periudhë raportuese në lëmin penale vërehet se në këtë fillim vit janë trajtuar numër i konsiderueshëm i lëndëve, gjë që sjell në konkluzion se numri i lëndëve të pranuara dhe atyre të përfunduara qëndron më mirë në Departamentin për Krimeve të Rënda me njëherë më shumë lëndë të kryera se të pranuara, ndërsa në Departamentin e Përgjithshëm edhe përkundër angazhimit, por duke vlerësuar edhe përfaqësimin edhe të degëve siç janë Leposaviqi dhe Zubin Potoku, mund të jemi tek një paralele në raport me lëndët e pranuara dhe të kryera.

**Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil:**

Departamenti civil është ballafaquar me numër të madh të lëndëve. Tremujori i fundit ka pasur një ngarkesë të jashtëzakonshme të padive të pranuara në gjykatë. Pothuajse vetëm në këtë 3 mujor është numri pothuajse i barabartë me tërë vitin 2023 ku kemi 1808 padi të reja të regjistruara, dhe shumica e këtyre padive janë në bazë të natyrës nga kontrata kolektive, por përkundër saj, angazhimi i gjyqtarëve ka qenë në nivelin më të mirë. Gjatë kësaj periudhe kohore kemi të përfunduara 1069 lëndë, duke e ditur se tani jemi duke u angazhuar me 8 gjyqtar, 3 nga këta janë ende ne fazën e trajtimit prane AD, ndërsa nëse e marrin mesataren mujore nga lendet e kryera me numrin e gjyqtareve prej 8, atëherë e kemi mesataren mujore prej 44.5. lëndë për secilin gjyqtar.

Një angazhim shumë lëmin përmbarimor Gjykata Themelore Mitrovicë për këtë tremujorësh ka pasur këtë gjendje: Lëndë në punë për këtë periudhë raportuese kanë qenë gjithsej 2668 lëndë, jane pranuar 152 lende, janë zgjidhur 620 lëndë e përqindja është 408% ne raport me te pranurat dhe te kryerat, por kjo nuk do te jete mates i joni, qëllimi është qe te kemi një tjetër gjendje, ashtu që në pritje kanë mbetur 2048 lëndë, duke e vlerësuar gjendjen nga viti I kaluar muaji Shtator 2023, ku kane qene 3900, jemi ne proces te mire te angazhimit, ne trajtim te ketyre lendeve.

Të dhënat e specifikuara si më lartë do të pasqyrohen në mënyrë të detajuar përmes tabelës së më poshtme të gjeneruar nga Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Lëndëve SMIL:

**Departmenti per kriem te Renda dhe Deparatamenti i pergjitheshem Divizioni Penal ;**

| Penale | A. Lëndët në pritje në fillimin e periudhës raportuese | B. Lëndët e pranuara në periudhën raportuese | Gjithsej në punë A+B | C. Lëndët e zgjidhura ne periudhën raportuese | D. P Lëndët në pritje në periudhën raportuese | E. Norma e zgjidhjes | F. Lëndët në pritje në fund të periudhës raportuese më të vjetra se 2 vite | G. Mesatarja e kohëzgjatjes e lëndëve të zgjidhura | H. Mesatarja e moshës e lëndëve në pritje ne fund te periudhës raportuese |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Penale përgjithshme Proceduré paraprake | 140 | 73 | 213 | 58 | 155 | 79% | 93 | 7.00 | 984.00 |
| Penale përgjithshme Shqyrtimi gjyqësor | 1188 | 142 | 1330 | 103 | 1227 | 73% | 611 | 848.00 | 986.00 |
| Krime të rënda Proceduré paraprake | 123 | 54 | 177 | 45 | 132 | 83% | 48 | 6.00 | 677.00 |
| Krime te renda Shqyrtim gjyqësor | 706 | 31 | 737 | 85 | 652 | 274% | 480 | 3,983.00 | 2,680.00 |
| Penale të mitur procedura paraprake | 34 | 9 | 43 | 5 | 38 | 56% | 12 | 2.00 | 557.00 |
| Penale të mitur Shqyrtimi gjyqësor | 182 | 4 | 186 | 16 | 170 | 400% | 56 | 1,236.00 | 778.00 |
| Procedure Paraprake-Departamenti Special | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 |
| Shqyrtim gjyqesor-Departamenti Special | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 |
| Lënde të pranuara me nën-lloj të lëndës të pa specifikuar dhe pa përfundim të regjistrimit | 3 | 0 | 3 | 0 | 3 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 |
| **Totali** | **2376** | **313** | **2689** | **312** | **2377** | **100%** | **1300** | **1,013.67** | **1,110.33** |

Vlen të ritheksohet se ky divizion e mbulon edhe Degën e Zubin Potokut dhe Leposaviqit, dhe gjatë kësaj periudhe raportuese gjyqtarët në këtë divizion janë ngarkuar me lëndë nga këto dy degë dhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2024 ky divizion sa i përket lëndëve nga dega në Zubin Potok kemi pasur këtë gjendje: Numri i lëndë në punë në këtë periudhë raportuese kanë qenë gjithësej 81 lëndë, ndërsa janë zgjidhur 7 lëndë, ndërsa në pritje kemi 74 lëndë, me një normë të zgjidhjes prej 78 %, ndërsa sa i përket degës në Leposaviq, për periudhën e parë raportuese kemi pasur këtë gjendje: Numri i lëndëve në punë ka qenë 394, ndërsa janë zgjidhur 97 lëndë, ashtuqë në pritje kemi 297 lëndë, me një normë të zgjidhjes prej 183%.

Për periudhën e parë raportuese për vitin 2024 Gjykata sipas statistikave ka pasur rezultate të mira përkundër gjendjes në të cilën jemi për shkak se jemi duke funksionuar me një staf të përgjysmuar që përfshin gjyqtarë dhe staf tjetër për shkak të dorëheqjeve të stafit serb, gjë që ka sjellur situatë vështirë të evitueshme, duke pasur parasysh se këto pozita nuk janë mbuluar edhe sot e kësaj dite. Sipas rezultateve të theksuara për këtë periudhë raportuese vërehet se në këtë fillim vit janë trajtuar numër mjaftë i madh i lëndëve, gjë që sjell në konkluzion se numri i lëndëve të pranuara dhe atyre të përfunduara qëndron paralel për këtë tremujor, ndërsa pritet që norma e zgjidhjes për këtë vit të rritet edhe më shumë dhe rezultatet të jenë edhe më të kënaqshme gjatë periudhave të tjera raportuese.

Të dhënat e gjeneruara nga SMIL lidhur me të thënat si më lartë, në mënyrë të detajuar janë paraqitur në tabelat si më poshtë për secilën degë:

## Dega Zubin Potok:

| Penale | A. Lëndët në pritje në fillimin e periudhës raportuese | B. Lëndët e pranuara në periudhën raportuese | Gjithsej në punë A+B | C. Lëndët e zgjidhura ne periudhën raportuese | D. P Lëndët në pritje në periudhën raportuese | E. Norma e zgjidhjes | F. Lëndët në pritje në fund të periudhës raportuese më të vjetra se 2 vite | G. Mesatarja e kohëzgjatjes e lëndëve të zgjidhura | H. Mesatarja e moshës e lëndëve në pritje ne fund te periudhës raportuese |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Penale përgjithshme Procedurë paraprake | 10 | 17 | 27 | 18 | 9 | 106% | 1 | 20.00 | 258.00 |
| Penale përgjithshme Shqyrtimi gjyqësor | 72 | 9 | 81 | 7 | 74 | 78% | 36 | 499.00 | 832.00 |
| Krime të rënda Procedurë paraprake | 2 | 0 | 2 | 0 | 2 | 0% | 0 | 0.00 | 380.00 |
| Krime të rënda Shqyrtim gjyqesor | 8 | 0 | 8 | 0 | 8 | 0% | 0 | 0.00 | 419.00 |
| Penale të mitur procedura paraprake | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 |
| Penale të mitur Shqyrtimi gjyqësor | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 |
| Procedure Paraprake-Departamenti Special | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 |
| Shqyrtim gjyqesor-Departamenti Special | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 |
| Lendë të pranuara me nën-lloj te lëndës te pa specifikuar dhe pa përfundim të regjistrimit | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 |
| Totali | 92 | 26 | 118 | 25 | 93 | 96% | 37 | 259.50 | 472.25 |

## Dega në Leposaviq:

| Penale | A. Lëndët në pritje në fillimin e periudhës raportuese | B. Lëndët e pranuara në periudhën raportuese | Gjithsej në punë A+B | C. Lëndët e zgjidhura ne periudhën raportuese | D. P Lëndët në pritje në periudhën raportuese | E. Norma e zgjidhjes | F. Lëndët në pritje në fund të periudhës raportuese më të vjetra se 2 vite | G. Mesatarja e kohëzgjatjes e lëndëve të zgjidhura | H. Mesatarja e moshës e lëndëve në pritje ne fund te periudhës raportuese |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Penale përgjithshme Procedure paraprake | 6 | 14 | 20 | 9 | 11 | 64% | 2 | 11.00 | 259.00 |
| Penale përgjithshme Shqyrtimi gjyqësor | 341 | 53 | 394 | 97 | 297 | 183% | 168 | 945.00 | 980.00 |
| Krime të rënda Procedurë paraprake | 1 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0% | 0 | 0.00 | 272.00 |
| Krime të rënda Shqyrtim gjyqësor | 2 | 0 | 2 | 0 | 2 | 0% | 0 | 0.00 | 338.00 |
| Penale të mitur procedura paraprake | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 |
| Penale te mitur Shqyrtimi gjyqesor | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 |
| Procedure Paraprake-Departamenti Special | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 |
| Shqyrtim gjyqesor-Departamenti Special | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 |
| Lëndë të pranuara me nën-lloj të lëndës te pa specifikuar dhe pa përfundim të regjistrimit | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 |
| Totali | 350 | 67 | 417 | 106 | 311 | 158% | 170 | 478.00 | 462.25 |

Në lëmin kundërvajtëse i tërë regjioni –GJTHM ka funksionuar me vetëm dy gjyqtarë, ndërsa me qëllim të riorganizimit dhe të evitimit të ngarkesës që ky departament ka, kemi vlerësuar të nevojshme që me një pjesë të lëndëve kundërvajtëse të ngarkohen edhe gjyqtarët nga divizioni

penal në Degën në Vushtrri. Rezultatet e punës dhe të dhënat statistikore tregojnë se duke përfshirë edhe Degët e Gjykatës Themelore Mitrovicë janë pranuar 841 lëndë të reja në lëmin kundërvajtëse, ndërsa janë përfunduara 708 lëndë, për çka gjyqtarët meritojnë vlerësim dhe konsideratë, dhe ky departament këtë tremujorësh në nivel degësh e përmbyll me 3015 lëndë në pritje.

**Gjykata Themelore Mitrovicë në Divizionin Civil, nga SMIL ka gjenderuar këto të dhëna:**

| Civile | A. Lëndët në pritje në fillimin e periudhës raportuese | B. Lëndët e pranuara në periudhën raportuese | C. Gjithsej në punë A+B | D. Lëndët e zgjidhura ne periudhën raportuese | E. Lëndët në pritje në periudhën raportuese | F. Norma e zgjidhjes | G. Lëndët në pritje në fund të periudhës raportuese më të vjetra se 2 vite | H. Mesatarja e kohëzgjatjes e lëndëve të zgjidhura | H. Mesatarja e moshës e lëndëve në pritje ne fund te periudhës raportuese | Koha ne dispozicion | Numri i lëndëve të pezulluara në pritje |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kontestimore | 6154 | 1808 | 7962 | 1069 | 6892 | 59% | 2663 | 640.00 | 897.00 | 2,719 | 0 |
| Jokontestimore | 160 | 50 | 210 | 32 | 178 | 64% | 77 | 131.00 | 899.00 | 2,395 | 0 |
| Permbarimore | 2516 | 152 | 2668 | 620 | 2048 | 408% | 516 | 729.00 | 530.00 | 1,571 | 0 |
| Administrative | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| Administrative-Divizioni fiskal | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| Ekonomike | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| Kontestet lidhur me investitorët e huaj | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| Kundërvajtje | 1010 | 385 | 1395 | 247 | 1148 | 64% | 56 | 307.00 | 286.00 | 2,061 | 30 |
| **Totali** | **9840** | **2395** | **12235** | **1968** | **10266** | **82%** | **3312** | **451.75** | **653.00** | **8,745.98** | **30** |

Po ashtu duke pasur parasysh faktin se Dega e Zubin Potokut dhe Dega e Leposaviqit, mbulohen nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, edhe rezultatet e arritura për këto dy degë, me tabelat si më poshtë:

**Në kuadër të Degës së Gjykatës në Zubin Potok kemi këto raporte:**

| Civile | A. Lëndët në pritje në fillimin e periudhës raportuese | B. Lëndët e pranuara në periudhën raportuese | C. Gjithsej në punë A+B | D. Lëndët e zgjidhura ne periudhën raportuese | E. Lëndët në pritje në periudhën raportuese | F. Norma e zgjidhjes | G. Lëndët në pritje në fund të periudhës raportuese më të vjetra se 2 vite | H. Mesatarja e kohëzgjatjes e lëndëve të zgjidhura | H. Mesatarja e moshës e lëndëve në pritje ne fund te periudhës raportuese | Koha ne dispozicion | Numri i lëndëve të pezulluara në pritje |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kontestimore | 28 | 4 | 32 | 0 | 32 | 0% | 7 | 0.00 | 608.00 | 0 | 0 |
| Jokontestimore | 2 | 0 | 2 | 0 | 2 | 0% | 0 | 0.00 | 555.00 | 0 | 0 |
| Permbarimore | 19 | 2 | 21 | 0 | 21 | 0% | 12 | 0.00 | 680.00 | 0 | 0 |
| Administrative | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| Administrative-Divizioni fiskal | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| Ekonomike | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| Kontestet lidhur me investitorët e huaj | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| Kundërvajtje | 17 | 0 | 17 | 0 | 17 | 0% | 7 | 0.00 | 718.00 | 0 | 0 |
| **Totali** | **66** | **6** | **72** | **0** | **72** | **0%** | **26** | **NaN** | **640.25** | **0.00** | **0** |

**Në kuadër të Degës së Gjykatës në Leposaviq kemi këto raporte:**

| Civile | A. Lëndët në pritje në fillimin e periudhës raportuese | B. Lëndët e pranuara në periudhën raportuese | C. Gjithsej në punë A+B | D. Lëndët e zgjidhura ne periudhën raportuese | E. Lëndët në pritje në periudhën raportuese | F. Norma e zgjidhjes | G. Lëndët në pritje në fund të periudhës raportuese më të vjetra se 2 vite | H. Mesatarja e kohëzgjatjes e lëndëve të zgjidhura | H. Mesatarja e moshës e lëndëve në pritje ne fund te periudhës raportuese | Koha ne dispozicion | Numri i lëndëve të pezulluara në pritje |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kontestimore | 101 | 15 | 116 | 9 | 107 | 60% | 79 | 198.00 | 1,050.00 | 4,704 | 0 |
| Jokontestimore | 9 | 0 | 9 | 0 | 9 | 0% | 6 | 0.00 | 1,287.00 | 0 | 0 |
| Permbarimore | 30 | 1 | 31 | 0 | 31 | 0% | 15 | 0.00 | 743.00 | 0 | 0 |
| Administrative | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| Administrative-Divizioni fiskal | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| Ekonomike | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| Kontestet lidhur me investitorët e huaj | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| Kundërvajtje | 24 | 0 | 24 | 1 | 23 | 0% | 4 | 701.00 | 624.00 | 8,760 | 1 |
| **Totali** | **164** | **16** | **180** | **10** | **170** | **63%** | **104** | **449.50** | **926.00** | **13,464.44** | **1** |

**Sa i përket rezulteteve të arritura nga dega e gjykatës Skenderaj, në lëmin penal për këtë tremujor kemi këtë gjendje:**

**Në procedurë paraprake** në periudhën raportuese Janar – Mars 2024 ky divizion ka pasur gjithësej në punë 50 lëndë, ndërsa për këtë interval kohor ka zgjidhur 20 lëndë, që lë në pritje një numër prej 30 lëndësh, me një normë të zgjidhjes së lëndëve në raport me lëndët e pranuara prej 71%.

**Në divizionin penal në Degën në Skenderaj** është i angazhuar vetëm një gjyqtar i cili, përkundër vështirësive që përballet, ka arritur që për këtë tremujor të ketë rezultate të mira në raport me zgjidhjen e lëndëve për këtë periudhë raportuese. Të dhënat për këtë divizion në Degën në Skenderaj janë si vijon: Lëndë në punë për këtë periudhë raportuese kanë qenë gjithësej 385 lëndë, ndërsa janë përfunduar 33 lëndë, ashtuqë lëndë në pritje kanë mbetur 352 sosh, me një normë të zgjidhjes në raport me lëndët e pranuara prej 94 %.

Të dhënat e detajuara lidhur me rezultatet e arritura në këtë degë janë të pasqyruara në tabelën si më poshtë:

| Penale | A. Lëndët në pritje në fillimin e periudhës raportuese | B. Lëndët e pranuara në periudhën raportuese | Gjithsej në punë A+B | C. Lëndët e zgjidhura ne periudhën raportuese | D. P Lëndët në pritje në periudhën raportuese | E. Norma e zgjidhjes | F. Lëndët në pritje në fund të periudhës raportuese më të vjetra se 2 vite | G. Mesatarja e kohëzgjatjes e lëndëve të zgjidhura | H. Mesatarja e moshës e lëndëve në pritje ne fund te periudhës raportuese |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Penale përgjithshme Procedurë paraprake | 22 | 28 | 50 | 20 | 30 | 71% | 12 | 4.00 | 555.00 |
| Penale përgjithshme Shqyrtimi gjyqësor | 350 | 35 | 385 | 33 | 352 | 94% | 128 | 699.00 | 770.00 |
| Krime të rënda Procedurë paraprake | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Krime të rënda Shqyrtim gjyqësor | 2 | 1 | 3 | 0 | 3 | 0% | 2 | 0.00 | 721.00 |
| Penale të mitur procedura paraprake | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 |
| Penale të mitur Shqyrtimi gjyqësor | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 |
| Procedure Paraprake-Departamenti Special | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 |
| Shqyrtim gjyqesor-Departamenti Special | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 |
| Lëndë të pranuara me nën-lloj të lëndës të pa specifikuar dhe pa përfundim të regjistrimit | 1 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 |
| **Totali** | **375** | **64** | **439** | **53** | **386** | **83%** | **142** | **351.50** | **682.00** |

**Sa i përket rezulteteve të arritura nga dega e gjykatës Vushtrri, në lëmin penal për këtë tremujor kemi këtë gjendje:**

**Në procedurë paraprake** në periudhën raportuese Janar – Mars 2024 ky divizion ka pasur gjithësej në punë 61 lëndë, ndërsa për këtë interval kohor ka zgjidhur 16 lëndë, që lë në pritje një numër prej 45 lëndësh.

**Në divizionin penal në Degën në Vushtrri** të dhënat janë si vijon: Lëndë në punë për këtë periudhë raportuese kanë qenë gjithësej 662 lëndë, ndërsa janë përfunduar 122 lëndë, ashtuqë lëndë në pritje kanë mbetur 540 sosh, me një normë të zgjidhjes në raport me lëndët e pranuara prej 167 %.

Të dhëna të detajuara lidhur me të thënat si më lartë janë pasqyruar në tabelën si më poshtë:

**Dega në Vushtrri**

| Penale | A. Lëndët në pritje në fillimin e periudhës raportuese | B. Lëndët e pranuara në periudhën raportuese | Gjithsej në punë A+B | C. Lëndët e zgjidhura ne periudhën raportuese | D. P Lëndët në pritje në periudhën raportuese | E. Norma e zgjidhjes | F. Lëndët në pritje në fund të periudhës raportuese më të vjetra se 2 vite | G. Mesatarja e kohëzgjatjes e lëndëve të zgjidhura | H. Mesatarja e moshës e lëndëve në pritje ne fund te periudhës raportuese |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Penale përgjithshme Procedurë paraprake | 38 | 23 | 61 | 16 | 45 | 70% | 17 | 7.00 | 676.00 |
| Penale përgjithshme Shqyrtimi gjyqësor | 589 | 73 | 662 | 122 | 540 | 167% | 223 | 737.00 | 797.00 |
| Krime të rënda Procedurë paraprake | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 |
| Krime të rënda Shqyrtim gjyqesor | 3 | 1 | 4 | 0 | 4 | 0% | 0 | 0.00 | 360.00 |
| Penale të mitur procedura paraprake | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 |
| Penale të mitur Shqyrtimi gjyqësor | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 |
| Procedure Paraprake-Departamenti Special | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 |
| Shqyrtim gjyqesor-Departamenti Special | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 |
| Lëndë të pranuara me nën-lloj të lëndës te pa specifikuar dhe pa përfundim të regjistrimit | 2 | 0 | 2 | 0 | 2 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 |
| **Totali** | **632** | **97** | **729** | **138** | **591** | **142%** | **240** | **372.00** | **611.00** |

**Sa i përket rezulteteve të arritura nga Dega e Gjykatës në Skenderaj, në lëmin civil për këtë tremujor kemi këtë gjendje:**

**Në lëmin Kontestimore** në periudhën raportuese Janar – Mars 2024 ky divizion ka pasur gjithësej në punë 2704 lëndë, ndërsa për këtë interval kohor ka zgjidhur 483 lëndë, që lë në pritje një numër prej 2221 lëndësh. Gjatë kësaj peroidhe kohore janë pranuar 961 lëndë. Norma e zgjidhjes në raport me numrin e lëndëve të pranuara është 50%.

**Nga lëmi Jokontestimor në Degën në Skenderaj** të dhënat janë si vijon: Lëndë në punë për këtë periudhë raportuese kanë qenë gjithësej 143 lëndë, ndërsa janë përfunduar 46 lëndë, ashtuqë lëndë në pritje kanë mbetur 97 sosh, gjatë kësaj periudhe janë pranuar 40 lëndë, ndërsa norma të zgjidhjes në raport me lëndët e pranuara është prej 115 %.

Nga lëmi përmbarimor në degën në Skenderaj kemi këtë gjendje: Lëndë në pritje për këtë periudhë raportuese kanë qenë 777 sosh, të pranuara 30 lëndë, ndërsa të përfunduara 85 lëndë, me një normë zgjidhjeje prej 283%. Numri i lëndëve në pritje në përfundim të kësaj periudhe raportuese ka qenë 722 lëndë.

Të dhënat e detajuara lidhur me rezultatet e arritura në këtë degë janë të pasqyruara në tabelën si më poshtë:

| Civile | A. Lëndët në pritje në fillimin e periudhës raportuese | B. Lëndët e pranuara në periudhën raportuese | C. Gjithsej në punë A+B | D. Lëndët e zgjidhura ne periudhën raportuese | E. Lëndët në pritje në periudhën raportuese | F. Norma e zgjidhjes | G. Lëndët në pritje në fund të periudhës raportuese e më të vjetra se 2 vite | H. Mesatarja e kohëzgjatjes e lëndëve të zgjidhura | H. Mesatarja e moshës e lëndëve në pritje ne fund te periudhës raportuese | Koha ne dispozicion | Numri i lëndëve të pezulluara në pritje |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kontestimore | 1743 | 961 | 2704 | 483 | 2221 | 50% | 695 | 291.00 | 568.00 | 2,043 | 0 |
| Jokontestimore | 103 | 40 | 143 | 46 | 97 | 115% | 24 | 108.00 | 521.00 | 1,135 | 0 |
| Permbarimore | 777 | 30 | 807 | 85 | 722 | 283% | 97 | 276.00 | 474.00 | 3,465 | 0 |
| Administrative | 1 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0% | 1 | 0.00 | 3,470.00 | 0 | 0 |
| Administrative - Divizioni fiskal | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0% | 0 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
